

NJOFTIM
Nr. 212/6, datë 6.3.2023

**PËR FILLIMIN E BISEDIMEVE MBI NËNSHKRIMIN E KONTRATËS
KOLEKTIVE TË PUNËS NË FUSHËN E MËSUESISË**

Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, konform njoftimit nr. 212/2, datë 13.1.2023, mbi fillimin e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës në fushën e mësuesisë, Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH) dhe Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH) kanë depozituar së bashku kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm, respektivisht nëpërmjet shkresës nr. 402 prot., datë 26.1.2023.

Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH) dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH), konform pikës 1, të nenit 163, të Kodit të Punës, në të cilin parashikohet, se: *“...Shumë organizata sindikale mund ta ushtrojnë këtë të drejtë së bashku”*, nëpërmjet shkresës nr. 402 prot., datë 26.1.2023, kanë deklaruar se do të hyjnë në bisedime dhe do ta nënshkruajnë së bashku Kontratën Kolektive të Punës në fushën e mësuesisë.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar nga ana juaj, shqyrtimit të treguesve të përfaqësueshmërisë, si dhe duke u bazuar në pikën 2, të nenit 164, të Kodit të Punës, në të cilin parashikohet, se: *“Organizata, që provon se ka numrin më të madh të anëtarëve punëmarrës në ndërmarrje ose në degë, vlerësohet si organizata më e përfaqësuar. Nëse disa organizata sindikale paraqiten së bashku, vlerësohet më i përfaqësuar grupi i organizatave që ka numrin më të madh të anëtarëve”*, vlerësohet se organizatën sindikale më të përfaqësuar janë Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH) dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH), të cilat deklarojnë se do të hyjnë së bashku në bisedime për nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës në fushën e mësuesisë.

Për sa më sipër, bazuar në procedurat ligjore të parashikuara në pikën 4, të nenit 163, të Kodit të Punës, ku përcaktohet, se: *“Punëdhënësi, të cilit i është kërkuar fillimi i bisedimeve, duhet ta bëjë kërkesën publike, duke e afishuar, në mënyrë të dukshme, gjatë dy javëve, në ndërmarrje. Nëse kërkesa është bërë në nivel dege, ajo duhet të afishohet në të gjitha ndërmarrjet ose degët. Organizata ose organizatat sindikale, që kërkojnë fillimin e bisedimeve, duhet të kujdesen që afishimi të kryhet në mënyrë të rregullt”*, njoftojmë fillimin e bisedimeve për nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës në fushën e mësuesisë me Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH) dhe Sindikatën e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH), të cilat deklarojnë se do të hyjnë së bashku në bisedime për nënshkrimin e saj.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi